

## Të drejtat e personave që ndihmojnë në vjelje dhe punonjësit deh punonjëset bujqësor në ndërmarrjet bujqësore

I nderuar anëtar i dhomës,

Dhoma e punonjësve të bujqësisë e Steiermarkt (Stmk. LAK) është përfaqësia e interesave për të gjithë punëdhënëset dhe punëdhënësit në bujqësi dhe në pylltari në Steiermark. Kush punësohet me një marrëdhënie shërbimi në një ndërmarrje bujqësore në Steiermark, është automatikisht anëtar i dhomës së Stmk. LAK. Ne dëshirojmë që në bashkëpunim me të gjitha autoritetet (shërbimi i tregut të punës, sigurimet shëndetësore të Austrisë, policinë financiare dhe inspektoriatin e bujqësisë dhe pylltarisë) të parandalojmë ankesat në sektorin e punës sezonale në bujqësi dhe prandaj ju informojmë juve mbi të drejtat tuaja për sa i përket pagesës, mbrojtjes së punëmarrësve dhe standardin minimal të banesave. Detyra kryesore e Stmk. LAK është **mbështetja falas** e anëtarëve të dhomës në çështjet e kodit të punës.

Për të gjitha marrëdhëniet e punës së personave që ndihmojnë në vjelje vlejné parimet e mëposhtme:

1. **Paga minimale** mujore (bruto) në varësi të marrëveshjes së pagës së bërë
  - € 1.500,00 për punonjësit e bujqësisë/për personat që ndihmojnë në vjelje
2. Nëse paguhet më pak se paga minimale, punëdhënësve i kanosen gjoha të larta.
3. Punëmarrësve i duhen dorëzuar **dokumente të ndryshme pune**.  
Kushtoni vëmendje sidomos, që juve
  - me fillimin e marrëdhënies së shërbimit t'ju dorëzohet regjistrimi te siguracioni shëndetësor Austriak
  - dhe çdo muaj një listë-pagesë.
4. Çdo punëmarrës posedon të drejtën që çdo vit të përfitojnë dy pagesa të veçanta („Pagën mujore të 13-të dhe 14-të“) me vlerën e një page mujore. Pa marrë parasysh kohëzgjatjen e punësimit, pagesat e veçanta i takojnë në çdo rast pjesërisht.
5. **Koha normale** javore e punës në rastin e punësimit të plotë është **40 orë**. Për orët shtesë që kalojnë përtej këtyre i takon normalisht edhe një shtesë mbi pagesën për orë.
6. Punëdhënësit janë të detyruar që të **mbajnë shënim orët e punës**. Sigurohuni që këto shënime t'ju dorëzohen dhe mbani gjithashtu edhe shënime vetjake me shkrim dorë mbi fillimin dhe përfundimin e kohës ditorë të punës si dhe pushimet e respektuara të punës.
7. Ju posedoni të drejtën për pesë javë **pushime** të gabuara për çdo vit pune
8. . Për pushime që nuk keni konsumuar, në fund të marrëdhënies së punës ju takon një kompensim („Shpërblim për zëvendësimin e ditëve të pushimit“.)

9. Në rastin e një **sëmundje** ju posedoni të drejtën për një vazhdim të pagesës së pagës për një periudhë kohore për një periudhë të caktuar kohore. Sëmundjen duhet t'ia bëni me dije menjëherë punëdhënësit. Në çdo mosmarrëveshje ju duhet të jeni në gjendje të vërtetoni që ju e bërë këtë raportim. Me kërkesë të punëdhënësit duhet të paraqitet një raport mjekësor për paaftësinë në punë. Raportet mjekësore të huaja duhet që ju vetë ti paraqisni brenda një javë pranë siguracionit shëndetësor austriak ose t'ia transmetoni atë asaj, përndryshe nuk mund të kryhet pagesa e parave kur ju jeni i sëmur.

Keni pyetje ose ju nevojitet ndihmë në realizimin e të drejtave tuaja? Na u drejtoni neve në:  
**Numri i telefonit +43 316/83 25 07 - 25**

---

## Puna gjatë të nxehtit

### Çfarë rreziqesh/ndalimesh kërcënohen gjatë punës në të nxehtë të madh dhe/ose nën rrezatim intensiv të rrezeve të diellit?

- rrezik i madh për aksidente, mundësi për të bërë gabime
- Goditja nga të nxehtit (skuqje të lëkurës, frymëmarrje e shpejtë, rrahje të shpejta të zemrës, turbullim të vetëdijes, Koma → Vini re: rrezik për jetën)
- Kolaps nga të nxehtit (rënie e presionit të gjakut, ndjenjë dobësie, marrje mendsh, të përziera dhe gjendje të fikëti)
- Goditje nga dielli (të përziera, marrje mendsh, dhimbje të mëdha koke)
- Djegie nga dielli, rrezik për krijimin e kancerit të lëkurës
- Ulje e rendimentit dhe cilësisë së punës (30-70 % në periudhën verore të të nxehtit)

### Ka „pushim për shkak të të nxehtit“?

- Me ligj nuk janë përcaktuar kufi temperature

→ nuk ekziston e drejta për të kërkuar „pushim për shkak të nxehtit“ në temperatura të caktuara.

POR: Punëdhënësi është i detyruar me ligj që të marrë masa, që ti mbajë sa më të ulëta të mundshme ngarkesat për shkak të të nxehtit (detyrimi i kujdesit kundrejt punëmarrësve).

Në raste të tilla masat kolektive (p.sh. hije kundrejt diellit) kanë prioritet kundrejt masave individuale (p.sh. kremi kundra diellit).

### Cilat janë masat për të cilat bëhet fjalë?

- Vënie në dispozicion e pijeve pa alkool
- Krijimi i hijeve në vendin e punës p.sh. duke vendosur çadra ose perde dielli
- Veshje mbrojtëse, p.sh. kapele kundra diellit, mbrojtje për qafën, jelekë freskues, veshje të sigurt kundrejt rrezatimit ultra violet, syze
- Substanca për mbrojtjen kundër diellit
- kontejnerë personeli/mjedise qëndrimi të ftohura
- Termus/frigorifer për pijet dhe ushqimet
- masa organizative (spostimi para i orarit të fillimit të punës, mënjanimi i të nxehtit të drekës)

- Instruktimi i punonjësve në dhënien e ndihmës së parë, sidomos në rastin e kolapsit për shkak të të nxehtit, goditjes nga dielli, goditjes nga të nxehtit
- Në mjedise të brendshme: Lehtësimi i rregulloreve të veshjeve (këpucë të lehta, veshje verore), vënia në dispozicion e ventilatorëve (mënjaroni ajrin që bën korrent), ajrosja në mëngjes dhe në mbrëmje (freskim i natës), krijimi i hijeve nëpërmjet grilave të jashtme

#### **Çfarë vlen për punët në ambientin e brendshëm?**

- Punëdhënësi duhet të kujdeset që të ruhen mundësisht temperaturat e mëposhtme:
  - a. Ngarkesë e ulët fizike (ulur, punë në zyrë): min. 19 °C dhe maks. 25°C Ngarkesë normale fizike (në këmbë): min. 18 °C dhe maks. 24 °C
  - b. Ngarkesë e lartë fizike (aktivitete artizanale): min. 12 °C
- Përjashtimet janë të mundshme, nëse lloji i përdorimit të ambientit nuk i lejon vlerat e mësipërme (p.sh. në sera, magazina frigoriferike)
- Nuk ekziston një e drejtë në parim për pajisjen me një sistem të ajrit të kondicionuar.

#### **Çfarë duhet bërë në rastet e emergjencës për shkak të të nxehtit – Masat për akordimin e ndihmës së parë?**

- Aktivizimi i zinxhirit të shpëtimit = Dhënësi/ja e ndihmës së parë (duke përfshirë telefonatën për te urgjenca) – Shërbimi i urgjencës – Spitali (në rast dyshimi informoni GJITHMONË shërbimet e shpëtimit!)
- Mos i lini punëdhënësit/et pa monitorim
- Vendosni të shtrirë në një ambient të freskët, vendosni këmbët sipër
- Jepini për të pirë
- pije me përbërje uji, vendosini shami të ftohta në qafë dhe mbi sipërfaqet e lëkurës